VENDIM
Nr. 598, datë 31.8.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I BULEVARDIT "JAKOV XOXA"", FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Rikonstruksion i bulevardit "Jakov Xoxa"", Fier.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe "tokë truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 10 194 753 (dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 194 753 (dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT PËR INTERES PUBLIK "RIKONSTRUKSIONI I BULEVARDIT "JAKOV XOXA""

NR.	PRONARI	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. m²	Çmimi lekë/m²	Amortizimi	Vlera (6x7x8)	Shpenzime administrative 7%	Vlera e ndërtesës	Vlerë trualli	vlera totale/leke	Gjendja juridike e pasurisë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
				TRUALL	120	12458					1,494,960		Inskriptuar në favor të bankës
1	bashkëpronarët Ramaj	ZK.8532	5/177	NDËRTESË	120	31599	40%	1,516,752	106,173	1,622,925		3,117,885	NBG Albania sh.a.
	Flamur Bilbil			TRUALL	46	12458					573,068		Konfirmim nga
2	Kafarani	ZK.8532	4/337	NDËRTESË	46	31599		1,453,554	101,749	1,555,303		2,128,371	ZVRPP-ja
3	Arta Gjini	ZK.8532	4/594	NDËRTESË	24	31599	60%	455,026	31,852	486,877		486,878	Konfirmim nga ZVRPP
4	Zhaneta Ristan Furxhiu	ZK.8532	6/261-N2	NDËRTESË	9	31599	60%	170,635	11,944	182,579		182,579	Konfirmim nga ZVRPP-ja
5	Luftar Zalo Agalliu	ZK.8532	6/261-N3	NDËRTESË	8.8	31599	60%	166,843	11,679	178,522		178,522	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	Luftar Zallo			TRUALL	27	12458					336,366		Konfirmim nga
6	Agalliu	ZK.8532	6/251	NDËRTESË	27	31599	60%	511,904	35,833	547,737		884,103	ZVRPP-ja
				TRUALL	27	12458					336,366		Konfirmim nga ZVRPP-ja
7	Arbër Arben Bekaj	ZK.8532	6/249	NDËRTESË	27	31599	60%	511,904	35,833	547,737		884,103	Konfirmim nga ZVRPP-ja
				TRUALL	35	12458					436,030		Inskriptuar në favor të Bankës së
8	Edmond Miço Thanasi	ZK.8532	6/234	NDËRTESË	32	31599		1,011,168	70,782	1,081,950		1,517,980	Parë të Investimeve
	Aleksander			TRUALL	17.6	12458					219,261		Plotësim
9	Zahoaliaj	ZK.8532	6/113-N1	NDËRTESË	17.6	31599		556,142	38,930	595,072		814,333	dokumentacioni
										Vlera totale		**10,194,753**	

Në përcaktimin e vlerës totale të pasurive jemi referuar: udhëzimi nr. 4, datë 30.9.2015 "Mbi miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave miratuar nga EKB" dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Mbi miratimin e vlerës së pasurisë të llojit tokë truall për qytetin Fier.